



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë, _____.2022

Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-Ndhmën Ekonomike dhe Ndhmën Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për periudhën 1-31 /03/2022 .

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6. Ligjit nr.147 datë 22.12.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”. Ligji sipas ligjit nr.57/2019 “ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, të V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 12, pikat 1,4,5,16, pika 2 dhe 21 të ligjit nr 57/2019 “Për asistencen Sociale në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5, pika 2, datë 17.02.2017 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Vendimit nr. 4 dhe nr. 5, datë 27.01.2022 të Këshillit Bashkiak Korçë , **“Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike” dhe nga fondi i buxhetit vendor të Bashkisë** si dhe duke u mbështetur në Ligjin Nr. 57/2019“ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”
Këshilli i Bashkisë në lidhje me pagesat e Ndhmës Ekonomike për muajin **Mars 2022**, sipas propozimit të Administratorëve shoqërorë :

VENDOSI

FONDI NË Lekë

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera konkludojmë dhe propozojmë:

1-Për muajin Mars 2022, është në dispozicion fondi prej 226.120 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike , nga sistemi i pikëzimit.

2- Nga ky fond, përfitojnë 45 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 113.542 lekë.

3- Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 26 familje, në shumën 31.552 lekë.

4- Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 145.094 lekë.

5- Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor ,sipas kriterëve specifike të miratuara 29 familje, me fond prej 92.114 lekë .

Ky fond është parashikuar si 6 % nga fondi i kushtëzuar, për bllok ndihmën ekonomike dhe nga fondi i buxhetit vendor, i miratuar me VKB nr.4 dhe nr.5 datë 27.01.2022.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Eva NAÇI

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Erjon NEXHIPI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë, __. __. 2022

MBI MBËSHTETJEN FINANCIARE TË FAMILJEVE QË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA BUXHETI VENDOR, PËR ZBUTJEN E EFEKTEVE TË NDIKUARA NGA LUFTA NË UKRAINË

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit plotësues nr. 1 datë 10.1.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë, VKB nr. 6 datë 27.1.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKM nr.159, datë 12.03.2022, “Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë” si dhe urdhrin nr. 42 datë 28.1.2022 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2022 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë”, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak miratimin e mbështetjes financiare për 27 familje në vlerën 243,000 lekë, si dhe mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

- 1- Të përfitojnë mbështetje financiare, **27 familje nga buxheti vendor**, në masën 3.000 (tre mijë) lekë, me fond prej **81.000 lekë**.
- 2- Fondi total për kryerjen e pagesave për një periudhë tre mujore, (Prill, Maj, Qershor 2022) është **243.000 lekë**.
- 3- Ky fond do të përballohet nga fondi i planifikuar në buxhetin e vitit 2022 përfundimisht tek individët, (Ndihmë ekonomike për familjet në nevojë), me këtë strukturë buxhetore:

00 10430 05 Art. 6060000 (Programi Kujdesi Social për Familje dhe Fëmijë)

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Eva NAÇI

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Erjon NEXHIPI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, Datë, __. __. 2022

MBI MIRATIMIN E FORMATIT TË APLIKIMIT

“ KËRKESA PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL ”

Bazuar në pikën 2 , neni 14 të ligjit 22/2018 “ Për Strehimin Social “ , pika 5 në V.K.M. nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”,

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi analizoi dhe shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale,

VENDOSI:

1. Të miratojë formatin e aplikimit “ Kërkesa për të përfituar nga programet e strehimit social “ , sipas modelit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale .
3. Ky vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Erjon Nexhipi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____, Datë, __. __. 2022

**PËR KORRIGJIMIN E NJË GABIMI MATERIAL NË TITULLIN E VENDIMIT Nr. 34
DATË 24.02.2022 MBI MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR
PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE TË PROGRAMIT “BANESA KOSTO TË ULËT”.**

Bazuarnënenin 54 tëligjit 139/2015 “Përvetqeverisjenvendore”, indryshuardheligjin 22/2018 “Përstrehimin social”, Kodin eProcedurës Administrative, Këshillii Bashkisë Korçë:

VENDOSI

1. Të korrigjojë titullin e VKB Korçë Nr. 34 dt. 24.02.2022 "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit “Banesat Sociale me Qira”, duke u riformeluar si më poshtë:

Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit “Banesat me Kosto të Ulët”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimittë Banesave Sociale.

3. Ky vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Erjon NEXHIPI



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/Vendim

Nr. Datë

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 146 DATË 22.12.2021 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2022”

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në VKM nr. 717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” i ndryshuar dhe në VKM nr. 158 datë 12.03.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”

VENDOSI:

1. Në VKB nr. 146 datë 22.12.2021 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në institucionin e Bashkisë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2022”, të ndryshohen kategoritë fikse për klasat I dhe II si më poshtë:

Kategoria fikse	Pagat sipas kategorive
Pika 19 klasa I	32 000
Pika 19 klasa II	32 000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Ndërmarrjet e varësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

Erjon NEXHIPI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

PËR

**PËR RIALOKIMIN E FONDEVE PËR SHPENZIMET E KRYERA TË PROJEKTIT
LED ME FINANCIM TE HUAJ (IPA)**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi morri në analizë relacionin e paraqitur nga Sektori i Integritimit Europian, si dhe Drejtoria e Financës, “Për rialokimin e fondve për shpenzimet e kryera të projektit “LED” me financim të huaj (IPA)”, Duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin plotësues nr. 1 datë 10.1.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë, VKB nr. 6 datë 27.1.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, urdhrin nr. 43 datë 28.1.2022 “Për detajimin e shpenzimeve për investime për vitin 2022 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve, udhëzimin nr. 8 datë 17.2.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj” si dhe në Marrëveshjen operationale midis Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Bashkisë Korçë, e datës 14.9.2019 “Për detyrat dhe përgjegjësitë në zbatimin e projekteve të financuara nga program Interreg IPA I bashkëpunimit ndërkuftar Greqi-Shqipëri 2014-2020” mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë rialokimin e fondeve për shpenzimet e kryera te projektit “LED” në vlerën 3.059.065 lekë sipas ndarjes së mëposhtme:

- Realizimi i aktiviteteve promovuese te projektit	652.000	lekë
- Blerje panelesh fotovoltaike dhe pajisje te tjera	1.306.923	lekë
- Blerje pajisjesh kompjuterike	1.100.142	lekë

Dhe me këtë strukturë buxhetore:

PAKËSOHET 00 04760 02 Art. 2300000 -3,059,065 lekë (Prog. Zhvill. i Turizmit, Bashkia)

SHTOHET 00 04760 05 Art. 6020000 +652,000 lekë (Prog. Zhvillimi i Turizmit, Bashkia)

SHTOHET 00 04760 05 Art. 2310000 +2,407,065 lekë (Prog. Zhvill. i Turizmit, Bashkia)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Financës, e Buxhetit dhe e MFK-së dhe Sektori i Integrimit European.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Erjon Nexhipi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË
P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

PËR PLANIFIKIMIN E BASHKEFINANCIMIT NË KUADËR TË HAPJES SË THIRRJES PËR PROGRAMIN “FONDI PËR MENAXHIMIN E FATKEQËSIVE NATYRORE”

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi morri në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit të territorit, Drejtoria e përgjithshme e Financës, buxhetit e MFK dhe Sektorit të Emergjencave, “Për planifikimin e bashkëfinancimit në kuadër të hapjes së thirrjes për programin “Fondi për menaxhimin e fatkeqësive natyrore” duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin plotësues nr. 1 datë 10.1.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë, VKB nr. 6 datë 27.1.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, si dhe urdhrin nr. 43 datë 28.1.2022 “Për detajimin e shpenzimeve për investime për vitin 2022 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve, si dhe mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë bashkëfinancimin prej 10% të shumës totale të projektit “Ndërrhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”, në vlerën 6,132,026 lekë të renditur si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i objektit	Vlera/lekë
1	Ndërtim mur mbajtës Kamenicë	683.884
2	Ndërtim kanali në Barç	16.705.526
3	Mur mbajtës në vend takimi i përroit të Dvoranit me lumin Dunavec	1.681.557
4	Mur mbajtës në vend takimi i përroit të Voskopit me lumin Dunavec	8.103.744
5	Ndërtim kanali në Drenovë	10.812.240
6	Mur mbajtës në argjinaturë të varrezat Pulahë	1.674.023

7	Mur mbajtës në rrugën "Lavdar i Vjetër- Lavdar i Ri" L = 70 m	4.112.031
8	Argjinatura e përroit të Mborjes nga ish Fabrika e Qelqit deri në dalje të fshatit (Variant me ngritje argjinature) L = 344ml	17.547.253

2. Ky fond do të përballohet nga fondi i planifikuar në buxhetin e vitit 2022 në programin Rrjeti Rrugor Rural, "Investime në Infrastrukturën Rrugore" me këtë strukturë buxhetore:

PAKËSOHET 00 04520 05 Art. 2310000 - 6,132,026 lekë (Prog. Rrjeti Rrugor Rural)
SHTOHET 00 03280 05 Art. 2310000 +6,132,026 lekë (Prog Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile)

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Sektori i Emergjencave Civile.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Erjon Nexhipi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

P/VENDIM

Nr _____, datë ____/____/2022

**‘PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA, TË OBJEKTIT ME
SIPËRFAQE TOTALE PREJ 390 M2, PJESË E PASURISË ME NR.4/167 VOL.42,
FQ.57. ZK 8564, NË ISH UMB KORÇË, SIPAS GENPLANIT BASHKËLIDHUR’**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe D.P.K.ZH.T bazuar në nenin 54 gërma e/1) të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.13 datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.54 date 05.02.2014”, si dhe në VKM Nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave për dhënien me qira të objektit me sipërfaqe totale prej 390 m2, pjesë e pasurisë me nr.4/167 vol.42, fq.57. zk 8564, në ish UMB Korçë, për një afat 1(një) vjeçar, me tarifën dysheme qirasë mujore prej 150 lekë/m2, sipas genplanit bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI
Erjon Nexhipi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr _____, datë ____/____/2022

“Për blerjen e sipërfaqeve tokë truall të cilat mbivendosen me pasuritë në pronësi të Dhimitraq Proto dhe Ilia Proto, mbi të cilat ndodhet Shkolla Demir Progri dhe baza prodhuese e shkollës Demir Progri”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe DPKZHT, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54 pika e) dhe në bazë neneve 705 e vijues të Kodit Civil, bazuar në VKM-në nr.89 datë 03.02.2016 « Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH” dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve

VENDOSI:

1. Të miratojë blerjen e sipërfaqeve si më poshtë vijon:
 - Për pasurinë 1/341 ZK 8561 vol 19 f 79, sipërfaqja e mbivendosur 92.7 m², vlera e pasurisë do të jetë 92.7 m² x 8537 lekë/m² = 791.380 lekë.
 - Për pasurinë 1/664 ZK 8561 vol 38, f 182, sipërfaqja e mbivendosur 28.6 m², vlera e pasurisë do të jetë 28.6 m² x 8537 lekë/m² = 244.158 lekë.
 - Për pasurinë 1/642 ZK 8561 vol 37 f 151, sipërfaqja e mbivendosur 753.4 m², vlera e pasurisë do të jetë 753.4 m² x 8537 lekë/m² = 6.431.776 lekë.
2. Vlerat e mësipërme do të paguhen me këste sipas parashikimeve në buxhetin e vitit përkatës.
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë të nënshkruajë kontratën e shitblerjes për sipërfaqet e sipërcituara në pronësi të bashkëpronarëve Z. Dhimitraq Proto dhe Ilia Proto, sipërfaqe të zëna me ndërtesën e Shkollës Demir Progri dhe baza prodhuese e shkollës Demir Progri.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe DPKZHT-ja.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Erjon Nexhipi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr _____, datë ____/____/2022

“Për blerjen e sipërfaqes prej 131 m2 tokë "arë" me nr.pasurie 59/3 zk 3030 në Porodinë, Njësia Administrative Bulgarec në pronësi të z.Hasan Hajridin Myrtollari, aktualisht sipërfaqe e zënë nga stacioni i pompimit të ujit”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe DPKZHT, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54 pika e) dhe në bazë neneve 705 e vijues të Kodit Civil, bazuar në VKM-në nr.89 datë 03.02.2016 « Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH" dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve

VENDOSI:

1. Të miratojë blerjen e sipërfaqes prej 131 m2 pasuri e llojit "arë" me vlerën 22 270 (njëzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë.
2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë të nënshkruajë kontratën e shitblerjes për sipërfaqen prej 131 m2 pasuria 59/3 Vol.72 Fq.45 ZK 3030 në pronësi të Z. Hasan Hajridin Myrtollari, sipërfaqe e zënë me stacion pompimi ujesjelles fshati Porodinë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe DPKZHT-ja.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Erjon Nexhipi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË
P/VENDIM**

Nr _____, datë ____/____/2022

**“PËR DHËNIEN ME QIRA TË AMBIENTEVE TË KATIT TË DYTË DHE TË TRETË
TË ISH KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË ME QËLLIM ZHVILLIMIN E
AKTIVITETEVE NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
KOMUNIKIMIT”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe D.P.K.ZH.T bazuar në nenin 54 gërma e/1) të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.13 datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.54 date 05.02.2014”, si dhe në VKM Nr.601 datë 31.8.2016 "Për kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Këshilli i Qarkut Korçë te Bashkia Korçë, dhe kalimin në pronësi të ndërtesës e të mjediseve administrative, nga Bashkia Korçë te Këshilli i Qarkut Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1223, datë 3.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në pronësi Këshillit të Qarkut Korçë” dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien me qira të ambienteve të katit të dytë dhe të tretë të ish godinës së Këshillit të Qarkut Korçë me qëllim zhvillimin e aktiviteteve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, me sipërfaqe 458 m² secili kat, sipas genplanit bashkangjitur.
2. Të autorizohet Kryetari i Bashkisë të fillojë procedurat ligjore për dhënien me qira të këtyre ambienteve, nëpërmjet procedurës me njoftim publik.
3. Të autorizohet Kryetari i Bashkisë të nënshkruajë marrëveshjet e qirasë për sipërfaqen totale ose të pjesshme të kësaj pasurie sipas afatave të mëposhtme:

- a) Për sipërfaqet deri në 200 m² = Afati i dhënies me qira = Deri në 5 vjet.
 - b) Për sipërfaqet 200-500 m² = Afati i dhënies me qira = Deri në 10 vjet.
 - c) Për sipërfaqet më shumë se 500 m² = Afati i dhënies me qira = Deri në 20 vjet.
4. Tarifa dysHEME e qirasë mujore me të cilën do të nisë procedura e konkurrimit nuk mund të jetë më e vogël se 150 lekë/m².
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Erjon Nexhipi



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

P/ Vendim

Nr. _____ Datë _____

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 23 DATË 10.02.2022 “PËR MIRATIMIN E
PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR INSTITUCIONIN E
BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2022”**

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” dhe në urdhëri e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 46 datë 01.02.2022 “Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2022” i ndryshuar

VENDOSI:

4. Të miratohen ndryshimet në planin vjetor 2022 të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë.
5. Të ndryshohet pika 3 e VKB-së nr. 23 datë 10.02.2022 “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2022”, të ndryshohet si më poshtë:
 - a) 1 Specialist projektues, 2 Specialistë për shqyrtimin e lejave, 1 Specialist për Infrastrukturën Mjedisore dhe 1 Specialist për Energjinë Elektrike në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, 1 Specialist topograf në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Drejtoria Juridike) si dhe 2 specialistë për çështjet urbane gjithsej **8 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në fushën e urbanistikës, arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit, topografisë etj, në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin urbanist, arkitekt, inxhinier ndërtimi, topograf etj.

- b) 4 Specialistë për agronom në Sektorin e Bujqësisë të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Agronomisë, në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin agronom.
 - c) 1 specialist Pyjesh në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, gjithsej **1 pozicion** i cili kërkon njohuri të posaçme dhe arsimim në fakultetin e Inxhinierisë së Mjedisit/Pyjeve etj. , në përfundim të të cilit të ketë fituar titullin përkatës.
6. Institucioni ku janë planifikuar vendet vakante është Bashkia Korçë.
 7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
 8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe shpallet në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar dhe Punësimit dhe atë të Bashkisë Korçë.

KRYETAR I KËSHILLIT

Erjon Nexhipi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

P/VENDIM

Nr. _____, Datë, ____/____/2022

**PËR DISA SHTESA NË V.K.B. Nr. 28, Datë 28.02.2019
"PËR PËRCAKTIMIN E PRIORITETEVE TË INVESTIMEVE
PËR VITET 2020 - 2022" TË NDRYSHUAR.**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi morri në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Financës, "Për disa shtesa në V.K.B. Nr.28, datë 28.02.2019 "Për përcaktimin e prioriteteve të investimeve për vitet 2020 -2022", V.K.B. 128, datë 29.10.2020 dhe Nr.142, datë 11.12.2020, "Përdisashesanë VKB Nr. Nr.28, datë 28.02.2019 "Përpërcaktimin e prioriteteve të investimeve për vitet 2020 - 2022", në mbështetje të ligjit nr ligjit nr 139/2015 "Përvetëqeverisjenvendore", ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Përmenaxhimin e sistemitbuxhetornë Republikën e Shqipërisë", indryshuar, ligjitnr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.115/2021 "Përbuxhetin e vitit 2022", udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", udhëzimit plotësues nr. 1 datë 10.1.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", VKB nr. 147 datë 22.12.2021 "Mbimratimin e buxhetit vitjetor 2022 të Bashkisë Korçë, VKB nr. 6 datë 27.1.2022 "Përrishqyrtimin e VKB nr. 147 datë 22.12.2021 "Përmiratimin e buxhetit vitjetor 2022 të Bashkisë Korçë", Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 28, datë 28.02.2019, 28, "Përpërcaktimin e prioriteteve të investimeve për vitet 2020 - 2022", sidhenë V.K.B. Nr 128, datë 29.10.2020 dhe Nr.142, datë 11.12.2020, "Përdisashesanë VKB Nr. Nr.28, datë 28.02.2019 "Përpërcaktimin e prioriteteve të investimeve për vitet 2020 - 2022", në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve,

VENDOSI :

1. Të miratojë (të mos miratojë) shtesat në prioriteteve të investimeve për vitet 2020 - 2022,

të cilat do të financohen nga të ardhurat e Bashkisë dhedonorë, si vijon:

Nëpikën A. InfrastrukturaPublikeTështohet:

24. Ndërhyrje për shmangjen e përmytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë, me vlerë totale
61.320.258 lekë me objektet si më poshtë :

I. Ndërtim muri mbajtës Kamenicë, me vlerë
683.884 lekë

II. Ndërtim kanali në Barç, me vlerë
16.705.526 lekë

III. Mur mbajtësnë vend takimiipërroitëDvoranit me luminDunavecme
vlerë**1.681.557** lekë

IV. Mur mbajtësnë vend takimiipërroitëVoskopit me luminDunavec me vlerë
8.103.744 lekë

V. NdërtimkanalinëDrenovë me vlerë
10.812.240lekë

VI. Mur mbajtësnëargjinaturëtevarrezatPulahë me vlerë
1.674.023 lekë

VII. Mur mbajtësnërrugën "LavdariVjetër- LavdariRi" L = 70 mme vlerë
4.112.031lekë

VIII. Argjinatura e përroitëMborjesngaishFabrika e Qelqitderinë
daljetëfshatit (Variant me ngritjeargjinature) L = 344m me
vlerë **17.547.253**lekë

23. Ndërtim tregu i gjësë së gjallë, me vlerë

të shtohet vlera edhe me

30.000.000 lekë

2.Përzbatimin e këtijvendimingarkohetEkzekutivi i Bashkisë.

3.Kyvendimhynnëfuqi 10 ditënga data e shpalljes.

KRYETARI

Erjon NEXHIPI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË
P-VENDIM**

Nr ____ Datë __. __.2022

PËR

**MIRATIM PËR PËRDITËSIMIN E KUFIJVE TË NJËSIVE
ADMINISTRATIVE**

Mbështetur në: *Ligji Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligji nr. 9270 datë 20.07.2004 Për Sistemin e Adresave (Nryshuar me ligjin nr.9951, datë 10.7.2008, nr. 89/2016, datë 15.9.2016) (i përditësuar), neni 4/1 që thekson se : "Çdo njësi e qeverisjes vendore krijon, përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave" dhe shkresa nr.44 prot. e datës 03/02/2022 e Ministrisë së Brendshme* ku kërkohet të azhurnohen kufijtë e ndarjeve administrative, përkatësisht për rendin e 4-t (Kufijtë e Njësive Administrative) dhe të 5-të (Kufijtë e Fshatra/Qytete) në formatin shapefile - GIS, në përputhje me standardet e miratuara për këtë temë të informacionit gjeohapësinor.

paraqesim këto kërkesa në Këshillin e Bashkisë për shqyrtim si më poshtë:

- Përditësimin e kufijve të njësive administrative si më poshtë:
Bashkëngjitur relacionit hartat përkatëse të njësive administrative.

Këshilli i Bashkisë, pasi u njoh me materialin, mbështetur në kompetencat që ka dhe pas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve,

VENDOSI :

- I. Të miratojë përditësimin e kufijve të njësive administrative si më poshtë:

Bashkia	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Korçë	Korçë	Qyteti Korçë
	Qendër Bulgarec	Fshatrat: Bulgarec, Lumalas, Biranj, Melcan, Porodinë, Dishnicë, Shamoll, Belorta, Kuç i Zi, Barç, Çiflig, Malavec, Neviçisht (13)
	Voskop	Fshatrat: Voskop, Dërsnik, Polen, Vinçan, Goskovë Lart, Goskovë Poshtë, Damjanec (7)
	Voskopojë	Fshatrat: Voskopojë, Shipskë, Krushovë, Gjonomadh, Lavdar (5)
	Lekas	Fshatrat: Lekas, Marjan, Gjonbabas, Gurmuja, Shkozan, Xerje, Tudas, Gjergjevicë, Lavdar Brozdovec, Mazrek, Poponivë (12)
	Vithkuq	Fshatrat: Vithkuq, Leshnje, Gjanc, Lubonjë, Rehovë, Roshanj, Trebickë, Grabockë, Treskë, Stratobërdh, Panarit, Shtyllë, Cemicë (13)
	Mollaj	Fshatrat: Mollaj, Floq, Pulahë, Ujë Bardhë, Kamenicë (5)
	Drenovë	Fshatrat: Drenovë, Mborje, Boboshticë, Moravë, Qatrom, Ravonik, Turan, Dardhë (8)

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

ERJON NEXHIPI

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË
P/V E N D I M

Nr. ____ datë ____ / ____ / 2022

Për

Dhënien e ndihmës financiare znj. Mariela Stefanllari për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e saj.

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e datës të sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjith. Juridike dhe B.NJ, Sektori Emergjencave Civile, bazuar në ligjin 45/2019”Për Emergjencat Civile”të nenit 29 të ligjit nr.139/2015”Për Vetqeverisjen Vendore”, V.K.M. nr. 329 datë 16.05.2012, “ Për kriteret e procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose nga veprimtaria njerëzore “, kreu III^{te}, pika 2 gërma ë, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “, i ndryshuar, në ligjin nr. 68 / 2017, “ Për financat e vetëqeverisjes vendore “,ligjit nr. 115/2021 “ për buxhetin e vitit 2022” udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit “ i ndryshuar,udhëzimit plotësues nr 1 datë 10.01.2022 “ Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “ Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë, VKB nr . 6 datë 27.01.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “ për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë.

V E N D O S I :

1. Ti jepet ndihmë financiare Znj. Mariela Stefanllari për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e saj ,një shumë prej **171.225 lek**
2. Shuma prej**171.225 lek** përkëtë familje, do të përballohet nga fondi i miratuar për Emergjencat Civile në buxhetin e Bashkisë për vitin 2022 në programin e mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjen civile me këtë strukturë buxhetore:

00 03280 05 Art.6060000 **171.225 lek**(mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile)

3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe M.F.K, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Manaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Emergjencave Civile në Bashki.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

ERION NEXHIPI